

Parandalimi i sëmundjeve te viçat fillon që me dhënien e kulloshtrës

Kujdesi i duhur ndaj viçave, që në lindje, është hapi i parë për një mbarështim të suksesshëm.

Veterineri Mag. Kritzinger nga SCHAUMANN Austri thekson sidomos dhënien e qumështit në kohën e duhur për një fillim të duhur në jetë. Brenda 2 orëve duhet që viçat të konsumojnë rreth 3-4 litra qumësht.

Cilësinë e qumështit nuk e dallon nga ngjyra, por nga qëndrueshmëria dhe jo çdo lopë ka gjithnjë një cilësi të mirë të qumështit. Për këtë duhet gjithmonë paraprakisht të ketë rezervë nga lopët e vjetra. Diarreja, sipas Kritzinger, është ndër problemet e para madhore tek viçat. Identifikimi në kohë, infuzioni i shpejtë me elektrolite dhe eliminimi i qumështit, janë masa të rëndësishme për ndalimin e diarresë tek viçat. Ai sugjeron planin e mëposhtëm të ushqyerjes (shiko tabelën), i rekomandueshëm për viçat me diarre.

Diarreja tek viçat e vjetër lidhet me faktorë patogjene specifik, si koksidia. Këtu është shumë e rëndësishme arka e desinfektimit. Për të luftuar koksidien ekzistojnë mjete të posaçme desinfektuese.

Racioni me lëndët e thata për viçat

Këshilltari i SCHAUMANN dhe Austria Praemix shpk, Ing.Franz Riegler tregon mbi eksperiencën e tij në përdorimin e lëndës së thatë për viçat.



Plani për viçat me diarre

Në mëngjes 1,5 – 2 litër qumësht

Paradite 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitësh

Në drekë 1,5 – 2 litër qumësht

Pasditë 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitësh

Në darkë 1,5 - 2 litër qumësht

Në darkë vonë 1 - 1,5 litër pije me përbërje elektrolitësh

MOS PËRZIENI APO HOLLONI QUMËSHTIN!

Zakonisht zhvillimi në kohën e duhur i rumenit është treguesi më i mirë për majmëri dhe mbarështim. Nëpërmjet përdorimit të koncentratit të viçave ose TMR e viçave me 25% përmbajtje bar nxitet pozitivisht zhvillimi i rumenit. Franz Riegler parashtroi avantazhet e Kälber-TMR në fermën e tij, përkatësisht procesin konkret të përzierjes, magazinimit dhe ushqyerjes. Me një përzierje prej 800 kg sanë dhe 40 kg melasë, ai mund të ushqejë viçat e tij për 2 muaj. Ai e ka përdorur që prej gjashtë muajsh këtë përzierje dhe është shumë i kënaqur me zhvillimin dhe rendimentin e viçave